REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:060764
Datë: 21.08.2020
Numri i dokumentit: 01072634

P.nr.84/20

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega ne Kaçanik, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri si gjyqtare e vetme , me procesmbajtësen Indira Beqa punëtore e kësaj gjykate, në lenden penale kundër te pandehurit A.M nga Fushe Kosova , për veprën penale Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijes kufitare nga neni 140 par 1 te KPRK-se, sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.362-6/20 te dates 26.05.2020, me propozim për dhënien e urdhrit ndëshkimor me 06.07.2020 merr këtë,

A K T G J Y K I M

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj PP.nr.362-6/20 te dates 26.05.2020, me propozim për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe gjykata jep ketë,

URDHER NDESHKIMOR

I pandehuri A.M , I lindur me dt. … ne …, nga I ati I…dhe e ema H…, e vajzerise F…, me adrese banimi ne Fushe Kosove rr.” …” pn. shqiptar, shtetas i Republikës së Serbise, I pa martuar, ka te kryer shkollen e mesme, punon si murator, I gjendjes se mesme ekonomike, me nr.personal :…. .

2020:060765

E shtë f a j t o r

Sepse me dt.31.03.2020 rreth ores 16:20 min. ne hyrje te Terminalit Doganor , I pandehuri ka kaluar ne kembe ilegalisht kufirin Maqedoni e Veriut - Kosove , ne vendkalimin e paautorizuar kufitar, ne ate menyre qe kishte shfrytezuar kohen kur ishte kolone e kamioneve dhe duke u fshehur prapa tyre ka arritur qe t'a kaloje kufirin, me ç'rast zyrtaret policorë kane reaguar dhe e kane ndaluar.

Me kete ka kryer vepren penale Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijes kufitare nga neni 140 par 1 te KPRK-se,

Prandaj gjykata ne baze te nenit 2,3,41,46 te KPRK-se, si dhe nenit 495 te KPPK-se

I shqipton

Denim me gjobë në shumën prej **250 €(dyqind e pesedhjete euro)** të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar qe ta paguaj ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk do të mund te paguaj dënimin me gjobë, i njëjti dënim do t'i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur për çdo 20 euro 1 dite burgim

Detyrohet i e pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor te paguaje prane kësaj gjykate shumën prej 20.00 € në afat te njejte me gjoben, nen kercnimin e permabrimit me dhune.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Ferizaj me aktakuzën PP.nr.362-6/20 te dates 26.05.2020, e akuzoi te pandehurin A.M nga Fushe Kosova , për veprën penale Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijes kufitare nga neni 140 par 1 te KPRK-se. Aktakuzes i ka bashkangjitur Kërkesën me numër dhe date te njëjte me te cilën ka propozuar qe ndaj te pandehurit të ipet Urdhëri Ndëshkimor dhe t' i shqiptohet dënim me gjobë.

Gjykata vlerësoi propozimin e Prokurorit Shtetit dhe pasi konstatoi se te dhënat e ofruara ne kërkesë paraqesin baze te mjaftueshme , vendosi qe te jep Urdherin ndëshkimorë.

2020:060765

Me rastin e shqyrtimit paraprak te çështjes ,gjykata konform nenit 495 te KPPK-se gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 te KPPK,se dhe konform nenit 495 par.1 te KPPK-se vendosi qe te pranoje kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor.

Gjykata gjeti se provat e bashkangjitura ne shkresat e lendes dhe atë deklarata e te pandehurit dhe raporti i oficerit Ismet jashari te dt.31.03.2020 si dhe fotografite qe gjenden ne shkresat e lendes, janë prova të besueshme me te cilat vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për te cilën është bere kërkesa për lëshimin e urdhrit ndëshkimor.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 450 dhe 453 par 1 të KPPK-se.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij urdhri ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
DEGA NE KAÇANIK
P.nr. 84/20 date 06.07.2020

Sekretarja Juridike **Gjyqtarja,**
Indira Beqa **Zajrete Muhaxheri**

Këshilla juridike,Kundër këtij Urdhri ndëshkimor i pandehuri mund te paraqet kundërshtim ne këtë gjykatë ne afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit,ne të kundërtën urdhri ndëshkimor merr formën e prere dhe është i ekzekutueshëm.

2020:060765